


Statistikat Tregtare të Kosovës, Tregtia e jashtme e mallrave, eksporti-importi me Malin e Zi

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) bilanci tregtar me Malin e Zi¹, për vitin 2025 ka bilanci pozitiv tregtar të mallrave me rreth 15.5 milionë euro një një ulje për rreth 16.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak. Mbulueshmëria e importit nga eksporti mbetet e lartë me rreth 137.6%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave me Malin e Zi, sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave në milionë euro, në % mbulueshmëria dhe rritje (v-m-v)

Viti	2022	2023	2024	2025
Eksport	38.3	45.0	44.5	56.8
Import	24.1	28.6	25.9	41.3
Bilanci tregtar	14.2	16.4	18.5	15.5
% e mbulimit	158.9%	157.1%	171.5%	137.6%
Rritje Exp. (v-m-v) %	56.2%	17.6%	-1.2%	27.8%
Rritje Imp. (v-m-v) %	-3.9%	18.9%	-9.4%	59.2%
Bila. Treg. (v-m-v) %	-	15.3%	13.3%	-16.2%


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

¹ Mali i Zi, zyrtarisht Republika e Malit të Zi, është një vend bregdetar / ballkanik në Evropën Juglindore, me kryeqytet Podgoricën. Ka një sipërfaqe prej 13,812 km² me rreth 0.63 milion banorë. Bruto Prodhimi Vendor (GDP) nominal për vitin 2026, vlerësohet me rreth rreth 10.23 miliardë \$ (dollar amerikan), me të ardhura për kokë banori (per capita) rreth 16,380 \$ (dollar amerikan), e renditur si ekonomia e 149-të për 2026, sipas Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Gjatë periudhës 2022–2025, Kosova ka regjistruar vazhdimisht një bilanc tregtar pozitiv me Malin e Zi, duke eksportuar më shumë mallra sesa ka importuar. Ndonëse vlera e bilancit arriti pikun në vitin 2024 me 18.5 milionë euro, ajo pësoi rënie në 15.5 milionë euro në vitin 2025 për shkak të një rritjeje të hovshme të importeve prej 59.2%.

Si rrjedhojë e këtij trendi, shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet ra në nivelin rreth 137.6% në vitin 2025 (nga 171.5% sa ishte në vitin 2024).

Figura 2. Eksport/Importi me Malin e Zi sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK)

Gjatë vitit 2025 vlera e mallrave të eksportuara për në Malin e Zi, shënoi rritje për 27.8% krahasuar me vitin paraprak, dhe arritën në 56.8 milionë Euro apo 6.0% si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm, renditet e gjashta në listën e 10 vendeve kryesore të eksportet.


Importi i mallrave nga Mali i Zi gjatë 2025, shënoi një rritjeje të hovshme prej 59.2% krahasuar me vitin paraprak, duke arritur në 41.3 milionë Euro apo 0.6% si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm.

Struktura e Eksportit/Importit me Malin e Zi në 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open DATA Doganat e Kosovës(DK) për vitin 2025 grupet kryesor të Eksportit e përbëjnë: 27.5% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 24.3% Produktet minerale 8.9% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe; 7.6% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre;

6.6% Artikuj të ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 5.4% Produkte të industrisë kimike; 4.6% Artikuj prej guri, allçie, prod. qeramike dhe qelqi, etj. si pjesë e strukturës së eksportit drejt Malit të Zi.

Figura 3. Struktura e Eksportit 2024-2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës (DK)

Rritja e eksporteve për 27.8% apo rreth 12.3 milionë euro më shumë mallra të eksportuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Produkte minerale, Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe dhe një rritje e lehtë të Makineri, paisje mekanike.

Struktura e eksporteve në vitin 2025 reflekton një diversifikim të rëndësishëm. Ndonëse Metalet bazë dhe artikuj prej tyre, mbeten dominuese me 27.5%, vërehet një rritje dinamike e Produkteve minerale (nga 19.9% në 24.3%), gjë që tregon forcimin e kapaciteteve nxjerrëse dhe përpunuese të Kosovës për në tregu malazez.

Te Importet për vitin 2025, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 50.1% Produkte minerale; 31.0% Druri dhe artikuj druri; 13.5% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 3.9% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm nga Mali i Zi.

Figura 4. Struktura e Importit 2024 - 2025 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovë (ASK) dhe OpenDATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 59.2% apo rreth 15.4 milionë euro më shumë mallra te importuara në vitin 2025 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve si Produkte minerale (nga 18.6% në 50.1%), vlen te theksohet se me mbi 90% e vlerës së përgjithshme të importeve te ky sektor, merr pjesë importi i energjisë elektrike (kodi 2716000000 - Energji elektrike).

Vlera importeve te sektori Druri dhe artikuj druri, tregon peshë dominuese në importet nga Mali i Zi, duke përbërë 53.6% të tyre në vitin 2024 dhe 31.0% në vitin 2025. Kjo lëndë e parë e importuar përpunohet në Kosovë dhe rikthehet në treg si produkt me vlerë të shtuar, ku Artikujt e ndryshëm të prodhuar (mobileri, krevat, dyshek, etj.) përbëjnë 7.3% në vitin 2024 dhe 6.6% për vitin 2025, të eksporteve totale të vendit drejt Malit të Zi. Importi i lartë i drurit tregon se për industrin përpunuese në Kosovës është i rëndësishëm ky furnizim, për të kompletuar/mbështetur zinxhirin prodhues të mobilieve dhe produkteve të tjera të drurit, për përdorim në sektorin e ndertimtarisë etj.